



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO		
KOMUNA E PODUJEVËS / OPŠTINA PODUJEVO / MUNICIPALITY OF PODUJEVA		
DIREKTORIA E ADMINISTRATËS - UPRAVA ADMINISTRACIJE		
Dërguar më Dostavljeno 21/02/2025		
Njësi.org. Org. Jed.	Nr. Br.	Shtojcë - Prilog
02-016	101-00	11697/25
PODUJEVË - PODUJEVO		



FUQIZIMII I GRAVE NGA KOMUNITETET E MARGJINALIZUARA ME AFTËSI SIPËRMARRJEJE DHE PROFESIONALE – FAZA II

Informacion i përgjithshëm

Projekti “Fuqizimi i grave nga komunitetet e marginalizuara me aftësi sipërmarrjeje dhe profesionale faza II” është vazhdimësi e projektit të kaluar “Fuqizimin social dhe ekonomik të grave përmes zhvillimit të aftësive dhe ndërmarrësisë” që ka treguar rezultate të jashtëzakonshme.

Që nga nëntori i vitit 2024, Fondacioni Jahjaga filloi implementimin e projektit “Fuqizimi i grave nga komunitetet e marginalizuara me aftësi sipërmarrjeje dhe profesionale - Faza II”, ky projekt i financuar nga Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) dhe implementuar nga Fondacioni Jahjaga – JF.

Përmbledhje e Projektit

Fondacioni Jahjaga, në kuadër të projektit të saj për fuqizimin socio-ekonomik të grave, po implementon program për ndërtimin e kapaciteteve për gra dhe vajza që përfshin trajnime profesionale dhe mbështetje psikosociale, që do zgjat nga nëntori 2024 deri në maj 2025. Ky projekt shtatëmuor ka për qëllim fuqizimin e grave përmes trajnimeve të përshtatura sipas nevojave dhe aftësive të tyre individuale, si dhe përmirësimin e mirëqenies së tyre emocionale dhe sociale.

Brenda këtij programi janë përfshirë gjithsej **45 gra** dhe vajza, ku **10 gra** nga **Podujeva** po marrin pjesë në trajnime profesionale në fushën e rrobaqepësisë dhe industrisë së bukurisë. Këto trajnime do të zgjasin për një periudhë tre mujore dhe do të zhvillohen në Institutin KTC, një institut i njohur dhe i akredituar nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve. Certifikatat që këto gra do të marrin pas përfundimit të trajnimit do të jenë të vlefshme si në Kosovë, ashtu edhe jashtë vendit. Në të njëjtën kohë, Fondacioni Jahjaga do të ofrojë mbështetje psikosociale për pjesëmarrëset përmes seancave terapeutike dhe grupe.

Me qëllim të realizimit të plotë të projektit dhe për të lehtësuar pjesëmarrjen e grave nga Podujeva, kërkojmë mbështetjen tuaj për **mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit për periudhën Shkurt–Mars 2025**.

Mbështetja juaj do të jetë një hap i rëndësishëm në fuqizimin e këtyre grave, duke i pajisur ato me aftësi të reja profesionale dhe duke përmirësuar ndjeshëm mirëqenien e tyre.



FAZA I: Ngritja e kapaciteteve përmes programit të trajnimit për aftësim profesional në industrinë e bukurisë dhe rrobaqepësisë (3 muaj),

Gjatë periudhës tremujore (trajnim profesional), përfitueset do të ndjekin një program trajnimi të krijuar dhe përshtatur për nevojat dhe aftësitë e tyre individuale, ndërsa paralelisht do t'u ofrohet mbështetje psikosociale përmes seancave terapeutike dhe grupe. Kjo qasje do t'i ndihmojë ato të krijojnë afërsi mes njëri-tjetrit dhe gjithashtu kjo u ndihmon atyre në zvogëlimin e stresit psikologjik dhe emocional.

FAZA II: Ndërmjetësimi për punësim

Pas përfundimit të fazës së trajnimit, ne do t'u ofrojmë grave përfituese shërbime ndërmjetësimi në punë duke u bërë urë lidhëse me kompani të shumta të kontraktuara në fusha përkatëse. Këto kompani që operojnë në të njëjtën fushë me programin tonë të trajnimit do të angazhojnë në kompanitë e tyre, gratë e diplomuara nga programi.

Koha dhe Vendodhja

Ky projekt ka për qëllim fuqizimin e grave në 4 komuna (Podujevë, Fushë Kosovë, Klinë dhe Novobërdë). Projekti do të zgjasë nga Nëntor 2024 deri në Maj 2025 dhe do të përfshijë programin e trajnimit, ndërmjetësimin e punës, dhe sesione psikosociale.

OBJEKTIVAT:

- Fuqizimi i grave përmes mbështetjes trajnim profesional për rrobaqepësi, industri të bukurisë dhe artizanat.
- Punë - ndërmjetësim për gratë përfituese me kompanitë e ndryshme private.
- Përmirësimi i gjendjes ekonomike të grave.
- Sigurimi i një faze monitorimi për të ndjekur progresin e grave dhe për të ofruar mbështetje nëse është e nevojshme;



Prishtinë, __/__/2025

**MARRËVESHJE E MIRËKUPTIMIT PËR BASHKËFINANCIMIN E PROJEKTIT
“Fuqizimii i grave nga komunitetet e marginalizuara me aftësi sipërmarrjeje dhe
profesionale – faza II”**

E lidhur ndërmjet

Fondacioni Jahjaga i përfaqësuar nga znj Egzona Bexheti, Drejtore Ekzekutive e Fondacionit Jahjaga (në tekstin e mëtejme Fondacioni),

dhe,

Komuna-Podujevë, i përfaqësuar nga Kryetari Shpejtim Bulliqi, (në tekstin e mëtejme Komuna),

**Neni 1
Qëllimi**

Qëllimi i kësaj Marrëveshje është bashkëfinancimi i projektit **“Fuqizimi i grave nga komunitetet e marginalizuara me aftësi sipërmarrjeje dhe profesionale – faza II”**, si dhe përcaktimi i obligimeve të ndërsjella ndërmjet Fondacionit dhe Komunës, për realizmin e këtij projekti.

**Neni 2
Vlera e projektit dhe mënyra e financimit**

1. Projekti **“Fuqizimi i grave nga komunitetet e marginalizuara me aftësi sipërmarrjeje dhe profesionale – faza II”** është duke u implementuar nga Fondacioni Jahjaga, me mbështetjen e donatorëve (UNMIK). Shuma totale e projektit është 40,000.00 \$ (dyzet mijë dollar).

**Neni 3
Obligimet e Fondacionit**

1. Fondacioni ndërmerr të gjitha hapat e duhur për implementimin me sukses të projektit.
2. Fondacioni harton projektin e detajuar dhe kurikulat e programit të trajnimit për gratë
3. Fondacioni krijon grupin e ekspertëve që ofrojnë ndihmën psikologjike
4. Fondacioni cakton një menaxher të projektit i cili shërben si pikë kontaktuese me Komunën.



Komuna e Podujevës



Neni 4 **Obligimet e Komunës**

1. Komuna monitoron dhe mirëmban të dhënat e përfitueseve nga komuna e Podujevës.
2. Komuna e Podujevës zotohet për mbështetjen financiare dhe bashkëfinancim të aktiviteteve që kanë në fokus fuqizimin ekonomik të grave të Komunës së Podujevës, në vlerë **1,000.00 € (një mijë Euro)**.
3. Cakton një zyrtar monitorues lidhur me implementimin e projektit i cili monitoron projektin dhe pranon raportet e implementimit sipas kërkesës.

Neni 5 **Ndryshimet dhe ndërprerja e Marrëveshjes së Mirëkuptimit**

Me pëlqimin paraprak të Drejtoreshës Ekzekutive dhe Kryetarit të Komunës, marrëveshja mund të ndryshohet, plotësohet apo ndërpritet.

Neni 6 **Zgjidhja e marrëveshjes**

Palët janë pajtuar në mes vete që kjo marrëveshje të zgjidhet me mirëkuptim.

Neni 7 **Numri i kopjeve**

Marrëveshja e Mirëkuptimit është nënshkruar në dy kopje, nga një kopje për secilën palë nënshkruese.

Neni 8 **Pronësia e projektit**


Me pranim dorëzimin e shërbimeve dhe detyrimeve të palëve, pronësia e projektit do mbetet në kuadër të Fondacionit.



Neni 9
Hyrja në fuqi

Marrëveshje e Mirëkuptimit fillon të zbatohet nga dita e nënshkrimit.

Kryetari i Komunës


Shpejtim Bulliqi



Drejtoresha Ekzekutive


Egzona Bexheti

